

## **8. Zhvillim - Vleresime**

Aktivitetet dhe iniciativat jane komunikuar familjeve gjate takimeve te pergjithshme ose individuale, me marreveshjen e mesuezve.

## **9. Informacione**

Per informacione te metejshme mund te drejtoheni ne sekretarine e Shkolles ose ne Sherbimet Sociale te Komunes suaj perkatese, ose ne Zuren per te Huajt nese funksionon ne Komunen tuaj.

Te dhena te metejshme mund ti kerkoni drejt per drejt ne drejtorine e kopshtit te zones suaj

# **PROGETTO CIAO**

## **Udhezues i vogel per Kopshtet**

## **per femijet e moshës nga 3 deri ne 6 vjeç**

**Scuola Infanzia**

**versione in lingua albanese  
perkthyer ne gjuhen Shqipe**

Depliant realizzato nell'ambito del  
**“Progetto C.I.A.O.”**  
– Con l'Italiano Andare Oltre –  
inserito nei Piani di Zona 2005-2007  
distretto socio-sanitario di Fidenza  
Provincia di Parma  
Regione Emilia Romagna

## 1. Kushtet e hyrjes

Femija juaj mund të rregjistrohet në kopesht nëse ka mbushur 3 vjeç brenda 31 Dhjetorit të vitit në vazhdim ose më 31 Janar të vitit që vjen.

Kerkohet pagesa e një shume mujore në baze të sigurise personale të femijes dhe ushqimit që konsumon.

## 2. Orari

Mbas një periudhe të shkurtër për të lehtësuar qendrimin e femijes në kopesht në ditët e para, koha e qendrimit do të jetë në mëngjes dhe mbazdite, nga e hënën deri të premten, në përgjithësi nga ora 8.00 deri më 16.00, deri më 30 Qershor. Shkolla është e mbyllur të Shtunave.

## 3. Guzhina

Paguhen vaktet që konsumohen. Menuja është e ndryshme dhe përfshin, mëngjesin, drekën, dhe mbazditen, Për arsye shëndetësore ( me recete nga mjeku) ose për arsye fetare është e mundur të ndryshosh mënyrën sipas kërkesave.

## 4. Transporti

Funksionon që ditën e parë të shkollës si për vajtjen dhe ardhjen nga shkolla. Nevojitet

- Te plotësoni një module kerkese në komunën që i përkisni
- Te paguani një shume mujore.

## 5. Mungesat

Nëse mungesat janë më shumë se gjashtë ( 6 ) ditë, kur hyni në shkollë duhet të sillni një çertifikatë nga mjeku pediater i femijes suaj. ; pa këtë çertifikatë nuk mund të hyni në shkollë.

## 6. Kalendari

Kopshtet fillojnë afërsisht nga mesi i Shtatorit dhe mbarojnë më 30 Qershor.

Aktivitetet shkollorë mund të mbyllën

- 15 ditë midis Dhjetorit dhe Janarit për festat e vitit të ri.
- 7 ditë në Mars ose Prill për festën e pashkës.

Ditët e tjera të pushimeve do të komunikohen drejt për drejt nga shkollat.

## 7. Aktivitetet shkollorë

Edukatorët punojnë me femijet për të favorizuar rritjen e tyre me lojëra, ushtrime fizike, shetitje në hapësirë, vizatime dhe dialogje.